




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i Biznesit: TDS SH.P.K

Numri unik identifikues: 811348251


Pronar: AM Invest Group SH.P.K dhe J&P PRO SH.P.K.

Person i autorizuar: Valon SHALA

Operatori i Shpërndarjes: "TDS SHPK"

Platforma: Satelitore

Adresa: Zona Industriale (ish Fabrika e Amortizatorëve), Prishtinë



VENDIM

për ndërprerjen dhe shpalljen e pavlefshme të licencës së Operatorit të Shpërndarjes TDS SHPK,
me seli në Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. TDS SHPK është operatorë i shpërndarjes i licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale përmes platformës Satelitore, në pajtim me Rregulloren KPM-2020/01, me seli në Klinë. KPM, me datën shkurt 2020, ka marr vendim për dhënien e licencës për Operatorin e Shpërndarjes TDS SHPK.
3. TDS SHPK, përmes një shkrese të dorëzuar në Zyrën Ekzekutive të KPM-së, ka njoftuar se heqë dorë nga licenca e operatorit të shpërndarjes, sipas platformës Satelitore.

Arsyetimi

4. Përmes kërkesës operatorit i shpërndarjes TDS SHPK ka deklaruar se arsye për heqje dorë nga licenca e KPM-së është kriza ekonomike si rezultat i pandemisë Covid – 19.
5. Duke u bazuar në njoftimin e pronarit të operatorit të shpërndarjes TDS SHPK, për heqje dorë nga licenca në mënyrë vullnetare, Komisioni vlerëson se ka bazë të mjaftueshme për ndërprerjen dhe shpalljen e pavlefshme të licencës së operatorit të shpërndarjes TDS SHPK.

Vendim

6. Komisioni në takimin e tij të mbajtur më datën 9 nëntor 2021, merr vendim për ndërprerjen dhe shpalljen e pavlefshme të licencës së Operatorit të Shpërndarjes TDS SHPK, me seli në Prishtinë, sipas njoftimit për heqje dorë në mënyrë vullnetare nga Licenca e KPM-së, ndërsa obligimet financiare të këtij operatori të shlyhen në pajtim me legjislacionin në fuqi.
7. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.


Xhevat LATIFI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



22. 11. 2021

datë